



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive	
Nr./Br./No.	3080
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	3 + 3 + 3
Data/Datum/Date:	13.08.2024
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.22/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
(MBPZHR) - NR. 05/2017 PËR RIPAKETIMIN E PRODUKTEVE PËR
MBROJTJEN E BIMËVE

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.22/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 05/2017 për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 34, nenit 35 paragrafi 6 dhe 10 të Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.44/22.12.2008), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.22/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR) -
NR. 05/2017 PËR RIPAKETIMIN E PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR.05/2017 për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që e përcakton lejen autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Neni 2

Në nenin 3, nën-paragrafin 1.7 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departament - nënkupton Departamentin për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalinë “Agjencia nënkupton Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 3

Neni 4, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ bazik në fund të paragrafit, pas pikës shtohet teksti si në vijim: “Kërkesa parashtrohet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim LPPA)”.

Neni 4 paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ bazik në fund të paragrafit pas pikës shtohet teksti si në vijim: “Plotësimi dhe dorëzimi i formularit të aplikimit mund të bëhet edhe përmes sistemit elektronik”.

Neni 4

1. Neni 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1. të Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet si në vijim:

“1.1. Të jetë i regjistruar si biznes”.

2. Neni 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3. të Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet si në vijim:
“1.3. Dëshminë ose inofrmatën për analizat e përgjithshme të PMB-ve, të lëshuar nga laboratorit i akredituar”;

3. Neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet si në vijim:

“1.7. Informatën e cila dëshmon kryerjen e inspektimit fitosanitar”.

4. Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet si në vijim:

“1.10. Informatën se posedon lejën për importim”;

Neni 5

Neni 12 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 6

Në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departament i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 7

Neni 14 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 8

Neni 15 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 9

Neni 16 i Udhëzimit Administrativ fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

Neni 16

Pezullimi dhe anulimi i lejes

Leja mund të pezullohet ose anulohet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.

Neni 10

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

